

Konsolidimi i pasqyrave financiare në Shqipëri


12.11.2025, Vjenë



Public Sector Accounting and Reporting Program

PULSAR is co-funded by:

 Federal Ministry
Republic of Austria
Finance

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO



Informacione të përgjithshme lidhur me konsolidimin

Përbërja e sektorit publik



3

Në sektorin publik të Shqipërisë përfshihen:

- 1) Njësitë shpenzuese buxhetore të administratës publike, ku përfshihen të gjitha njësitë e klasifikuara në sektorin e qeverisjes së përgjithshme, sipas nënsektorëve:
 - Qeverisja qendrore,
 - Qeverisja vendore,
 - Fondet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
- 2) Njësitë e klasifikuara si jashtëbuxhetore nuk përfshihen në procesin e buxhetit vjetor.
- 3) Njësitë shpenzuese të klasifikuara si ndërmarrje publike jo financiare;
- 4) Njësitë shpenzuese të klasifikuara si ndërmarrje publike financiare.

Përbërja e sektorit publik



4

Sektori publik	Viti 2024
Qeverisja qendrore (nga të cilat):	877
<i>Buxhetore</i>	820
<i>Jashtëbuxhetore</i>	57
Qeverisja vendore (nga të cilat):	278
<i>Buxhetore</i>	195
<i>Jashtëbuxhetore</i>	83
Fondet e sigurimeve shoqërore	2
Shoqëri publike jo financiare	37
Shoqëri publike financiare	2
Banka qendrore	1
Gjithsej	1.197

Kuadri ligjor



5

Ligji organik i buxhetit përcakton kuadrin për sektorin e qeverisjes së përgjithshme:

- a) bazën kontabël me të drejta dhe detyrime të konstatuara, të modifikuar;
- b) detyrimin që njësitë ekonomike shtetërore të mbajnë një sistem kontabël dhe të hartojnë pasqyra financiare vjetore në bazë të udhëzimeve/manualëve të MF-së;
- c) MF-në si institucionin përgjegjës për hartimin e standardeve, akteve nënligjore dhe metodikës të kontabilitetit të sektorit publik;
- d) detyrimin e Thesarit për të mbajtur një sistem kontabilizimi dhe raportimi të veprimeve të qeverisë, përfshirë hartimin e pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme; dhe
- e) përbërjen e raportit të konsoliduar të buxhetit vjetor të hartuar nga MF-ja, që i dorëzohet për miratim qeverisë dhe Kuvendit.

Buxhetimi në sektorin publik



6

Të gjitha raportet financiare, përfshirë raportet e zbatimit të buxhetit, hartohen dhe paraqiten për çdo vit kalendarik të mbyllur më 31 dhjetor sipas këtyre afateve:

- pasqyrat financiare në nivel të njësisë ekonomike hartohen brenda 31 marsit të vitit pasardhës;
- pasqyrat financiare të konsoliduara në nivel të grupit hartohen brenda 30 prillit të vitit pasardhës;
- MF-ja nxjerr dhe dorëzon raportin e konsoliduar të buxhetit për sektorin e qeverisjes së përgjithshme për miratim pranë Këshillit të Ministrave brenda fundit të majit të vitit pasardhës;
- Këshilli i Ministrave ia paraqet raportin e konsoliduar të buxhetit për sektorin e qeverisjes së përgjithshme Kuvendit brenda fundit të qershorit të vitit pasardhës; dhe
- pas miratimit nga Kuvendi, raporti i konsoliduar i buxhetit për sektorin e qeverisjes së përgjithshme botohet në Fletoren Zyrtare brenda fundit të tetorit të vitit pasardhës.

Miratimi i raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit



7

● **Përgjegjësitë e Këshillit të Ministrave (brenda qershorit):**

- Miraton dhe i paraqet Kuvendit raportin vjetor të konsoliduar për zbatimin e buxhetit.

● **Raporti përfshin:**

- Pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit
- Raporti për zbatimin e buxhetit vjetor (fondet e livruara & objektivat e arritur)
- Raportin për borxhin publik dhe përbërjen e tij
- Përdorimi i fondeve rezervë dhe të paparashikuara
- Raporti i kontrollit të brendshëm financiar publik për njësitë e qeverisjes së përgjithshme

● **Publikimi**

Ministria e Financave publikon raportin e miratuar brenda qershorit të çdo viti



Procesi i konsolidimit

Konsolidimi



9

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë pasqyrat financiare të një njësie ekonomike në të cilat paraqiten aktivet, detyrimet, aktivet neto/kapitali neto, të ardhurat, shpenzimet dhe flukset monetare të njësisë kontrolluese dhe të njësive të kontrolluara, si të ishin të një njësie të vetme ekonomike.

Qëllimi




Pasqyrat e konsoliduara financiare kanë qëllimin e përgjithshëm t'u japin informacion të besueshëm organeve përkatëse vendimmarrëse, nëpërmjet:

- Dhënies së informacionit për burimeve financiare dhe shpërndarjen e tyre;
- Dhënies së informacionit mbi mënyrën e financimit të aktiviteteve të njësive dhe realizimin e kërkesave për mjete monetare;
- Dhënies së informacionit në lidhje me aftësinë e njësisë për të financiar aktivitetet dhe për të përmbushur detyrimet dhe angazhimet; dhe
- Dhënies së informacionit për vlerësimin e ecurisë së njësive raportuese.

Procesi i raportimit financiar



11



Përbërja



12

- Pasqyra financiar e konsoliduar e pozicionit financiar (pasqyra e bilancit);
- Pasqyra financiare e konsoliduar e performancës financiare;
- Pasqyra financiare e konsoliduar e ndryshimeve në aktivet/fondet neto;
- Pasqyrat financiare e konsoliduar e ndryshimeve në flukset monetare;
- **Pasqyra statistikore** të tilla si pasqyra statistikore për investimet dhe burimet e financimit të tyre, pasqyra financiare për aktivet afatgjata (me kosto historike), pasqyra financiare për aktivet afatgjata (me vlerën neto) dhe pasqyra financiare e numrit të punonjësve dhe fondit të pagave
- Dhënies së **shënimeve shpjeguese** për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare të konsoliduara.

Dhënia e informacioneve shpjeguese për konsolidimin




13

Informacionet shpjeguese kryesore në lidhje me konsolidimin përfshijnë:

- ✓ përbërjen e njësisë ekonomike (lista e njësive ekonomike të kontrolluara);
- ✓ interesin që kanë njësitë jo kontrolluese në aktivitetet dhe flukset monetare të njësive ekonomike;
- ✓ Natyrën dhe ndryshimet e rreziqeve të lidhura me interesat e njësive ekonomike në njësitë e kontrolluara jo të konsoliduara dhe njësitë e strukturuar që nuk konsolidohen.

Konsolidimi



Procedurat e konsolidimit



- ✓ Harmonizimi i politikave kontabël nëpërmjet njësisë ekonomike;
- ✓ Harmonizimi i datave të raportimit të njësive ekonomike të kontrolluara me ato të njësisë ekonomike kontrolluese;
- ✓ Përkthimi i pasqyrave financiare të operacioneve të huaja në monedhën e paraqitjes të njësisë ekonomike;
- ✓ Konsolidimi zë për zë i pasqyrës së performancës financiare, pasqyrës së pozicionit financiar dhe pasqyrës së flukseve monetare të njësive ekonomike kontrolluese dhe të kontrolluara;
- ✓ Eliminimi i plotë i tepricave brendapërbrenda njësisë ekonomike dhe i veprimeve midis njësive ekonomike brenda njësisë ekonomike, përfshirë aktivet, detyrimet, aktivet neto, të ardhurat, shpenzimet, dividendët ose shpërndarje të ngjashme dhe flukset monetare;
- ✓ Kontabilizimi i Interesave jo kontrolluese;
- ✓ Eliminimi i investimit të njësisë kontrolluese në njësinë e kontrolluar kundrejt aktiveve neto (kapitalit neto) të njësisë ekonomike.

Procesi i konsolidimit në Shqipëri (Pasqyrat e performancës financiare - të dhënat mbi financat buxhetore)

16

Nivelet e konsolidimit

Konsolidimi në nivel njësie

Ministritë, institucionet qendrore, bashkitë dhe fondet speciale integrojnë të dhënat e njësive vartëse (për pasqyrat e performancës financiare - të dhënat e financave buxhetore dhe pasqyrat e pozicionit financiar)

Konsolidimi në nivel të qeverisjes qendrore

Ministria e Financave agregon të dhënat financiare të të gjitha institucioneve të nivelit qendror dhe organeve të varësisë (vetëm për pasqyrat e performancës financiare - të dhënat e financave buxhetore)

Konsolidimi si qeverisje e përgjithshme

Ministria e Financave bashkon të dhënat e qeverisjes qendrore dhe vendore për një pozicion të unifikuar në nivel vendi (vetëm për pasqyrat e performancës financiare - të dhënat e financave buxhetore)


Plani i veprimit 2025-2030



17

Vënia në zbatim e SNKSP-ve

në Shqipëri



Sfidat në kontabilitetin e sektorit publik



18

❖ Regjistra të paplotë të aktiveve dhe pasiveve

- shumë njësi ekonomike nuk kanë inventarë të plotë;
- vlerësimi dhe verifikimi i aktiveve publike mbeten të pjesshme.

❖ Boshllëku në burime njerëzore dhe aftësi

- Formim dhe certifikim i pamjaftueshëm i kontabilistëve publikë;
- Nivel i ulët njohurish për kontabilitetin me të drejta dhe detyrime të konstatuara.

❖ Kuadër i paplotë ligjor dhe rregullator

- Mungesa e një ligji për kontabilitetin e sektorit publik (në hapat e fundit të miratimit);
- Aktet nënligjore dhe manualet (projektmetodologjia e raportimit financiar në sektorin publik).

Sugjerime për vendet e tjera



19

❖ **Vënia në zbatim në faza**

- Të vendosen piketa të qarta (inventarizimi, vlerësimi, integrimi i sistemeve) me afate realiste.

❖ **Vendosja e një plani kombëtar tranzicioni**

- Ministria qendrore të bashkërendojë fazat, të nxjerrë udhëzime dhe të monitorojë progresin në të gjitha nivelet e qeverisjes.

❖ **Hartimi i manualeve të standardizuara të kontabilitetit**

- Të unifikohet klasifikimi, plani kontabël dhe procedurat e eliminimit përmes udhëzimeve ligjërisht të detyrueshme.

❖ **Investim në formim që në fillim**

- Të ngrihet një sistem i vazhdueshëm arsimor profesional për kontabilistët publikë dhe audituesit e brendshëm.

❖ **Konsolidime pilot para vënies plotësisht në zbatim**

- Të fillohet me njësitë qendrore, të përsoset metodologjia, pastaj të shtrihet më gjerë në njësitë e qeverisjes vendore dhe në fondet jashtëbuxhetore



FALEMINDERIT!